



Zyra e OSBE-së për Institucione
Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut



Grupi kërkimor Max Planck Minerva
për Pavarësinë Gjyqësore

REKOMANDIMET E KIEVIT PËR PAVARËSINË E GJYQËSORIT NË EVROPËN LINDORE, KAUKAZIN JUGOR DHE AZINË QENDRORE

-Administrimi gjyqësor, përzgjedhja dhe përgjegjshmëria-

Kiev, 23-25 qershor 2010

Pavarësia e gjyqësorit është një element i domosdoshëm i të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, i shtetit të së drejtës dhe demokracisë. Në përpjekje për të mbështetur vendet e Evropës Lindore, Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore për forcimin e pavarësisë gjyqësore në përputhje me këto parime, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) së bashku me Institutin “*Max Planck Minerva*” për të drejtën e krahasuar publike dhe ndërkombëtare (MPI), organizuan dhe drejtuan në Kiev një takim mbi pavarësinë gjyqësore me specialistë të rajonit. Në këtë takim morën pjesë rreth 40 specialistë të pavarur, ndër të cilët kishte studiues të shquar dhe praktikues me përvojë nga 19 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni i tij i Venecias.

Pas një studimi të thelluar të sistemit ligjor dhe praktikave lidhur me pavarësinë gjyqësore, ODIHR dhe MPI zgjodhën tri tema veçanërisht të rëndësishme për pavarësinë gjyqësore. (1) Administrimi i gjyqësorit, duke u përqendruar tek këshillat gjyqësorë, organet gjyqësore vetëqeverisëse dhe rolin e kryetarëve të gjykatave; (2) Përzgjedhja e gjyqtarëve – kriteret dhe procedurat; dhe (3) Përgjegjshmëria e gjyqtarëve dhe pavarësia e gjyqësorit në gjykim. Takimi përfundoi me miratimin e një liste joshteruese rekomandimesh (bashkëngjitur “Rekomandimet e Kievit për pavarësinë gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore”). Këto rekomandime kanë për qëllim të forcojnë më

tej pavarësinë e gjyqësorit në rajon, në të tria fushat e zgjedhura tematike.

Shtetet pjesëmarrëse ftohen të rishikojnë idetë e rekomandimeve të Kievit, të evidentojnë fushat ku praktika e tyre i korrespondon tashmë asaj që është rekomanduar dhe të shkëmbejnë informacionet përkatëse me ODIHR-in. Mbi këtë bazë, ODIHR-i do të bëjë të mundur shkëmbimin e ekspertizës dhe do të ofrojë asistencë teknike në interes të shteteve pjesëmarrëse të cilat shprehin interesin për të forcuar më tepër pavarësinë e gjyqësorit të tyre duke zbatuar masat e parashikuara në Rekomandimet e Kievit.¹

¹ Ky dokument u publikua nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut me titull "Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë e Gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Azinë Qendrore". Ky përkthim jozyrtar në gjuhën shqipe u përgatit nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Pjesa I – Administrimi gjyqësor

1. Administrimi i gjykatave dhe i gjyqësorit duhet të rrisë gjykimin e paanshëm dhe të pavarur në përputhje me të drejtat për një proces të rregullt dhe shtetin e të drejtës. Administrimi gjyqësor nuk duhet përdorur asnjëherë për të ndikuar në përmbajtjen e vendimmarrjes gjyqësore. Procesi i administrimit gjyqësor duhet të jetë transparent.

Këshillat gjyqësorë, komisionet e kualifikimit dhe organet vetëqeverisëse

Ndarja e kompetencave në administratën gjyqësore

2. Këshillat gjyqësorë janë organe me detyra të caktuara të administrimit gjyqësor dhe kompetenca të pavarura për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit. Për të evituar përqendrimin e tepruar të pushtetit një në organ gjyqësor dhe perceptimet e korporatizimit, rekomandohet që të bëhet dallimi dhe ndarja e kompetencave të ndryshme, siç janë përzgjedhja (*shih paragrafët 3-4 dhe 8*), ngritja në detyrë dhe trajnimi i gjyqtarëve, disiplina (*shih paragrafët 5, 9, 14, 25-26*), vlerësimi profesional (*shih paragrafët 27-28*) dhe buxheti (*shih paragrafin 6*). Një alternativë e mirë do të ishte caktimi i organeve të ndryshme të pavarura kompetente për aspekte të caktuara të administrimit gjyqësor pa ushtruar mbi to kontroll nga një institut apo autoritet i vetëm. Përbërja e këtyre organeve duhet të reflektojë detyrat e tyre të përcaktuara. Puna e tyre duhet të rregullohet me ligj dhe jo me udhëzime ekzekutive.

Përzgjedhja e gjyqtarëve

3. Nëse nuk ka një organ të pavarur të ngarkuar me këtë detyrë, duhet të krijohet një komision i posaçëm specialistësh për të bërë provimet me shkrim dhe me gojë gjatë procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve (*shih gjithashtu paragrafin 8*). Në këtë rast kompetenca e këshillit gjyqësor duhet të kufizohet në verifikimin e kryerjes së procedurave të rregullta, dhe ose të emërojë kandidatët e përzgjedhur nga komisioni, ose t'ia rekomandojë ata autoritetit emërues. (*Për procesin e rekrutimit shih paragrafët 21-23.*)

4. Ndryshe nga ajo që u tha më sipër, për përzgjedhjen dhe trajnimin e gjyqtarëve mund të jenë drejtpërdrejt përgjegjës këshillat gjyqësorë ose komisionet e kualifikimit apo kolegjet e kualifikimit. Në këtë rast është me shumë rëndësi që këto organe të mos jenë nën kontrollin e ekzekutivit dhe të veprojnë të pavarura nga qeveritë e rajonit (*për përbërjen shih gjithashtu paragrafin 8*).

Disiplina

5. Për të parandaluar akuzat për korporatizëm dhe për të garantuar një procedurë të rregullt disiplinore, këshillat gjyqësorë nuk do të jenë kompetentë për dy aspektet e mëposhtme: a) të marrin ankesa dhe të kryejnë hetim disiplinor dhe në të njëjtën kohë b) të dëgjojnë një çështje dhe të marrin vendim për masa disiplinore. Vendimet disiplinore duhet t'u nënshtrohen shqyrtimit të një gjykate kompetente (*shih gjithashtu paragrafët 9, 14, 25-26.*)

Këshilla mbi buxhetimin

6. Pa cenuar përgjegjësitë ekzistuese të qeverisë në propozimin e buxhetit gjyqësor dhe të parlamentit për miratimin e buxhetit, do të ishte e këshillueshme që organi i cili përfaqëson gjyqësorin, siç është për shembull një këshill gjyqësor, t'i paraqiste qeverisë nevojat e sistemit të drejtësisë për buxhet, në mënyrë që të bëhet e mundur një proces të mirëinformuar vendimmarrjeje. Ky organ duhet të dëgjohet edhe në parlament gjatë debatit për buxhetin. Këshillat gjyqësorë mund të luajnë një rol edhe në shpërndarjen e buxhetit brenda gjyqësorit.

Përbërja e këshillave gjyqësorë

7. Kur krijohet një këshill gjyqësor, anëtarët gjyqtarë të tij do të zgjidhen nga kolegët e tyre dhe do të përfaqësojnë gjyqësorin në shkallë të gjerë, duke përfshirë edhe gjyqtarë të shkallës së parë. Këshillat gjyqësorë nuk duhet të mbizotërohen nga gjyqtarë të gjykatës së apelit. Kur një kryetar gjykate emërohet në këshill, ai ose ajo duhet të heqë dorë nga pozicioni si kryetar i gjykatës. Përveç një numri të konsiderueshëm anëtarësh të këshillit të zgjedhur nga gjyqtarët, në përbërje të këshillit gjyqësor duhet të ketë edhe profesorë të së drejtës dhe do të ishte mirë të kishte edhe një anëtar të dhomës së avokatisë, për të pasur një bazë më të gjerë përfshirjeje dhe më tepër transparencë. Prokurorët duhet të përjashtohen në atë vende ku ata nuk bëjnë pjesë në të njëjtin institucion gjyqësor me gjyqtarët. Nga pjesëmarrja në këshill duhet të përjashtohen gjithashtu edhe përfaqësues të tjerë të organeve të zbatimit të ligjit. As presidenti i shtetit dhe as ministri i drejtësisë nuk duhet të kryesojnë këshillin. Kryetari i këshillit gjyqësor duhet të zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të këshillit. Puna e këshillit gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përfaqësues të ekzekutivit apo legjislativit.

Anëtarësia e organeve që vendosin përzgjedhjen gjyqësore

8. Anëtarët e komisioneve të posaçme për përzgjedhjen gjyqësore (*shih paragrafin 3*) duhet të emërohen nga këshilli gjyqësor nga radhët e profesionistëve të ligjit, duke përfshirë edhe anëtarë të gjyqësorit. Në rastet kur këshillat gjyqësorë, komisionet e kualifikimit apo kolegjet e kualifikimit janë drejtpërdrejt përgjegjës për përzgjedhjen e gjyqtarëve (*shih paragrafin 4*), anëtarët duhet të emërohen për afate të përcaktuara.

Përveç një numri të konsiderueshëm anëtarësh në këtë organ përzgjedhës, do të ishte mirë të përfshiheshin edhe grupe të tjera (profesorë të së drejtës, avokatë) dhe kjo duhet vendosur në bazë të kulturës dhe përvojës përkatëse ligjore. Përbërja e këshillit duhet të bëjë të mundur që për post gjyqësor arsyet politike të mos marrin epërsi ndaj kualifikimeve të një kandidati (*shih paragrafin 21*).

Anëtarësia e organeve që vendosin disiplinën

9. Organet kompetente për të dëgjuar një çështje disiplinore dhe për të marrë vendim për masa disiplinore (*shih paragrafin 5, b*) nuk duhet të përbëhen vetëm nga gjyqtarë, por edhe nga jogjyqtarë. Gjatë mandatit të tyre, anëtarët gjyqtarë nuk duhet të kryejnë funksione të tjera që kanë të bëjnë me gjyqtarët apo komunitetin gjyqësor, siç janë administrimi, buxhetimi apo përzgjedhja në gjyqësor. Organet që vendosin për çështje disiplinore nuk duhet të kontrollohen nga ekzekutivi dhe mbi to nuk duhet të ketë asnjë ndikim politik. Duhet mënjanuar çfarëdolloj kontrolli nga ekzekutivi mbi këshillat gjyqësorë apo organet e ngarkuara me çështje të disiplinës (*shih gjithashtu paragrafët 5, 25-26*.)

Transparenca e administratës gjyqësore

10. Këshilli gjyqësor duhet të mbliidhet rregullisht në mënyrë që t'i përmbushë detyrat e tij. Mundësia e publikut për të qenë i pranishëm në diskutimet e këshillit gjyqësor dhe publikimi i vendimeve të tij duhet të garantohet në ligj dhe në praktikë.

Roli i kryetarëve të gjykatave

11. Roli i kryetarëve të gjykatave duhet të kufizohet vetëm në kuptimin e mëposhtëm: ata mund të marrin funksione gjyqësore të cilat janë të barasvlershme me ato të ushtruara nga anëtarët e tjerë të gjykatës. Kryetarët e gjykatave nuk duhet të ndërhyjnë në gjykimet e bëra nga gjyqtarë të tjerë dhe as nuk duhet të përfshihen në përzgjedhjen e gjyqtarëve. Ata nuk duhet të kenë vendimmarrje as në lidhje me shpërblimet (*shih paragrafin 13 për shpërblimet dhe privilegjet*). Ata mund të kenë funksione përfaqësuese dhe administrative, ku përfshihet edhe personeli jo-gjyqësor. Funksionet administrative kërkojnë trajnim në aftësitë drejtuese. Kryetarët e gjykatave nuk duhet të keqpërdorin kompetencat e tyre në shpërndarjen e mjeteve/burimeve të gjykatës, për të pasur ndikim mbi gjyqtarët.

Caktimi i çështjeve

12. Vendimet administrative të cilat mund të ndikojnë gjykimin real (të mirëfilltë) nuk duhet të jenë kompetencë ekskluzive e kryetarëve të gjykatave. Një shembull është caktimi i çështjeve, i cili ose duhet të jetë i rastësishëm, ose të bëhet në bazë kriteresh të qarta dhe objektive të paracaktuara nga një bord gjyqtarësh të gjykatës. Pasi të jetë vendosur një mekanizëm shpërndarjeje, nuk duhet ndërhyrë më në të.

Shpërblimet dhe privilegjet individuale

13. Në një perspektivë afatgjatë, shpërblimet dhe privilegjet duhet të hiqen dhe pagat të rriten në nivelin e duhur për të përmbushur nevojat e gjyqtarëve për një standard të përshtatshëm jetese dhe të pasqyrojnë siç duhet përgjegjësinë e profesionit të tyre. Për sa kohë ekzistojnë shpërblimet dhe privilegjet, ato duhet të jepen në bazë të kritereve të paracaktuara dhe një procedure transparente. Kryetarët e gjykatave nuk duhet të kenë të bëjnë me vendimmarrjen mbi shpërblimet dhe privilegjet.

Roli i kufizuar në disiplinimin e gjyqtarëve

14. Kryetarët e gjykatave mund të depozitojnë një ankesë tek organi, i cili është kompetent për marrjen e ankesave dhe kryerjen e hetimeve disiplinore (*shih paragrafin 5,a*). Për të siguruar një shqyrtim të pavarur dhe objektiv të ankesës, kryetarët e gjykatave nuk duhet të kenë autoritetin për të nisur apo për të miratuar një masë disiplinore.

Mandati i kufizuar

15. Kryetarët e gjykatave duhet të emërohen me një mandat të kufizuar disavjeçar dhe të drejtë rinovimi vetëm një herë. Në rast emërimi ekzekutiv, mandati duhet të jetë i shkurtër dhe të mos rinovohet.

Përzgjedhja transparente dhe e pavarur e kryetarëve të gjykatave

16. Përzgjedhja e kryetarëve të gjykatave duhet të jetë transparente. Pozicioni i hapur për kryetar gjykate duhet të publikohet dhe për këtë pozicion mund të aplikojnë të gjithë gjyqtarët të cilët kanë vitet e mjaftueshme të punës dhe përvojën e nevojshme. Organi kompetent për përzgjedhjen mund t'i intervistojë kandidatët. Një alternativë e mirë do të ishte që gjyqtarët e një gjykate të caktuar ta zgjedhin vetë kryetarin e gjykatës përkatëse. Në rastin e një emërimi ekzekutiv, një organ këshillimor –si për shembull një këshill gjyqësor apo komision kualifikimi (*shih paragrafin 4*) – duke marrë parasysh edhe pikëpamjet e gjykatës përkatëse duhet të ketë të drejtë të bëjë një rekomandim, të cilin ekzekutivi mund ta rrëzojë vetëm me një vendim të argumentuar. Në këtë rast, organi këshillimor mund të rekomandojë një kandidat tjetër. Për të siguruar mbrojtje ndaj ndikimit të tepërt të ekzekutivit, organi këshillimor duhet të jetë në gjendje ta hedhë poshtë vendimmarrjen e ekzekutivit me shumicë të cilësuar votash.

Pjesa II – Përzgjedhja dhe trajnimi i gjyqtarëve

Mundësia për t'u bërë gjyqtar

17. Mundësia për t'u bërë gjyqtar u duhet dhënë jo vetëm juristëve të rinj me trajnimin e specializuar, por edhe juristëve që kanë një përvojë të konsiderueshme në profesion (pra,

të krijohet mundësia e hyrjes në gjyqësor në mes të karrierës). Niveli i përvojës së fituar në profesionin përkatës, sipas të cilit kandidatët mund të kualifikohen për të aplikuar për poste gjyqësore, duhet vlerësuar me kujdes.

Përmirësimi i arsimimit ligjor

18. Aksesimi në profesionin e gjyqtarit duhet të kufizohet me ata kandidatë që kanë një diplomë të nivelit lartë në drejtësi. Në kurrikulën universitare i duhet dhënë më tepër rëndësi stërvitjes së aftësive analitike. Duhet përfshirë elemente të tilla si raste studimore, eksperiencë praktike, klinika ligjore dhe simulime gjyqësore. Duhet garantuar e njëjta cilësi arsimimi në universitetet shtetërore edhe ato private, si dhe në arsimin në distancë. Një vlerësim i jashtëm i kurrikulave të universiteteve mund të kontribuonte pozitivisht në përmirësimin e tyre.

Përmirësimi i trajnimit të veçantë për gjyqtarët

19. Atje ku shkollat për gjyqtarët janë pjesë e procedurës së përzgjedhjes, ato duhet të jenë të pavarura nga pushteti ekzekutiv. Programet e trajnimit duhet të përqendrohen tek ajo që i nevojitet shërbimit gjyqësor dhe të plotësojnë arsimin universitar. Në to duhet të përfshihen aspekte të etikës, aftësi komunikuese, aftësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, aftësi drejtuese dhe aftësi të hartimit të teksteve ligjore. Në ato vende ku ekziston një këshill gjyqësor, ai mund të vërë në praktikë rekomandime për arsimimin ligjor të gjyqtarëve. Këtu përfshihen përcaktime për aftësitë e nevojshme dhe këshilla për arsimimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve.

20 Trajnime të veçanta, siç parashikohen në pikën 19, duhen bërë edhe për përfaqësuesit e profesioneve të tjera në fushën e drejtësisë që hyjnë në gjyqësor.

Procesi i rekrutimit

21. Për të siguruar transparencë në procesin e përzgjedhjes, procedura dhe kriteret për përzgjedhjen e gjyqtarëve duhen përcaktuar qartë në ligj. Njoftimi për pozicionet e lira, si dhe afatet dhe kushtet, duhet të bëhen publike dhe të shpërndahen gjerësisht. Lista e të gjithë kandidatëve që aplikojnë (ose të paktën e atyre që kanë kaluar përzgjedhjen e parë) duhet të bëhet publike. Organi përzgjedhës duhet të jetë i pavarur, përfaqësues dhe i përgjegjshëm përpara publikut (*shih paragrafët 3-4*). Ky organ duhet të marrë në intervistë të paktën kandidatët të cilët kanë arritur raundin e fundit, me kusht që tema e intervistës dhe pesha e saj në procesin e përzgjedhjes të jetë e paracaktuar.

22. Nëse do të ketë kontroll të figurës së kandidatëve, këto informacione duhen trajtuar me kujdesin më të madh dhe vetëm në aspektin e zbatimit të ligjit. Autoriteti përzgjedhës mund të kërkojë një kontroll standard për precedentë penalë si dhe arsye të tjera skualifikuese nga policia. Rezultatet e këtij kontrolli duhet t'i tregohen edhe aplikuesit, i

cili duhet të jetë në gjendje t'i ankimojë në gjykatë. Nuk duhet bërë asnjë kontroll tjetër nga asnjë shërbim tjetër sigurie. Vendimi për të refuzuar një kandidat në bazë të këtyre kontrolleve duhet të jetë i arsyetuar.

23. Kur emërimin përfundimtar të një gjyqtari e bën President i Shtetit, vendimi i emërimit duhet bërë vetëm ndër kandidatët e emëruar nga organi përzgjedhës (p.sh. Këshilli Gjyqësor, Komisioni i Kualifikimit apo Komisioni i Ekspertëve (*shih paragrafët 3-4*). Refuzimi për të emëruar një kandidat të tillë duhet të bazohet vetëm për shkaqe procedurale dhe duhet arsyetuar. Në këtë rast organi përzgjedhës duhet ta rishikojë vendimin e tij. Një alternativë do të ishte që organit përzgjedhës t'i jepej autoritet për të hedhur poshtë veton e presidentit me shumicë të cilësuar votash. Te gjitha vendimet duhet të merren brenda një kohe të shkurtër siç parashikohet në ligj.

Përfaqësimi i minoriteteve brenda gjyqësorit

24. Në përgjithësi, do të ishte e preferueshme që përbërja e gjyqësorit të reflektonte përbërjen e gjithë popullsisë. Për të rritur përfaqësimin e minoriteteve në gjyqësor, grupet e nënpërfaqësuar duhet të nxiten që të marrin kualifikimet e nevojshme për t'u bërë gjyqtarë. Askush nuk duhet të përjashtohet ngaqë i përket një grupi të caktuar minoritar.

Pjesa III – Përgjegjshmëria e gjyqtarëve dhe pavarësia e gjyqësorit në gjykim

Procedimet disiplinore

25. Procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve duhet të trajtojnë rastet e akuzave për sjellje të keqe profesionale të cilat janë flagrante dhe të pajustificueshme dhe krijojnë një reputacion të keq për gjyqësorin. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve nuk shtrihet tek përmbajtja e vendimeve të tyre, ku përfshihen edhe interpretimet e ndryshme ligjore ndërmjet gjykatave; ose tek rastet e gabimeve gjyqësore, apo kritikën ndaj gjykatës.

Organ i pavarur i cili merr vendime në lidhje me disiplinën

26. Për gjykimin e rasteve të disiplinës gjyqësore (*shih paragrafin 9*) duhet të ngrihet një organ i veçantë i pavarur. Organet të cilat gjykojnë raste të disiplinës gjyqësore nuk mundin që t'i nisin ato apo të kenë në përbërje të tyre anëtarë që mund t'i nisin këto çështje disiplinore. Këto organe duhet t'u sigurojnë gjyqtarëve të akuzuar garanci procedurale, ku përshihet edhe e drejta për të paraqitur një mbrojtje dhe e drejta për t'iu drejtuar një gjykate kompetente. Si rregull, seancat disiplinore për gjyqtarët duhet të jenë transparente. Këto seanca do të jenë të hapura, me përjashtim të rasteve kur gjyqtari i akuzuar kërkon që të jenë të mbyllura. Në këtë rast vendos gjykata nëse kërkesa është e justifikuar. Vendimet që kanë të bëjnë me disiplinën gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Vendimet përfundimtare për masa disiplinore duhet të botohen.

Vlerësimi profesional i gjyqtarëve

27. Aty ku bëhen vlerësime profesionale për gjyqtarët, ato nuk duhet të përdoren për të dëmtuar gjykimin e pavarur. Vlerësimi i punës së gjyqtarëve duhet të jetë kryesisht cilësor dhe i përqendruar në aftësitë e tyre, ku përfshihen aftësitë profesionale (njohja e ligjit, aftësia për të drejtuar gjyqet, aftësia për të shkruar vendime të arsyetuara), aftësitë personale (aftësia për të përballuar ngarkesën e punës, aftësia për të marrë vendime, përshtatja me teknologjitë e reja), aftësitë shoqërore (aftësia për të ndërmjetësuar, respekt për palët) dhe për një avancim të mundshëm në një pozicion administrativ, aftësi për të drejtuar. Po këto aftësi duhet të kultivohen në programet e trajnimeve gjyqësore dhe në punë.

28. Gjyqtarët nuk do të vlerësohen në asnjë rrethanë për përmbajtjen e vendimeve të tyre (qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet llogaritjes së numrit të vendimeve të kthyer). Mënyra se si e gjykon një gjyqtar çështjen nuk duhet të shërbejë asnjëherë si bazë për dënim. Statistikat për efikasitetin e veprimtarisë së gjykatës duhet të përdoren kryesisht për arsye administrative dhe duhet të shërbejnë vetëm si një nga faktorët për vlerësimin e gjyqtarëve. Vlerësimet e gjyqtarëve mund t'u shërbejnë atyre për të identifikuar aspekte të punës së tyre, të cilat ata mund të duan t'i përmirësojnë dhe për qëllime të një avancimi të mundshëm. Provimet periodike për gjyqtarët (verifikimet) që mund të çojnë në largime nga puna apo në sanksione të tjera, nuk janë të përshtatshme për gjyqtarët me pozicion të përjetshëm.

29. Kriteret për vlerësimin periodik duhet të jenë të përcaktuara qartë, transparente dhe uniforme. Kriteret bazë duhet të përcaktohen në ligj. Kriteret e sakta që përdoren në vlerësimet periodike, si dhe afatet dhe mekanizmat e kryerjes së vlerësimit, duhet të përcaktohen në rregullore të mëposhme.

Vlerësimet e pavarura

30. Megjithatë këshilli gjyqësor mund të luajë një rol në përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave, vlerësimet profesionale duhet të bëhen në nivel lokal. Kryesisht, vlerësimet duhet të bëhen nga gjyqtarë të tjerë. Kryetarët e gjykatave nuk duhet të kenë kompetencën ekskluzive për të vlerësuar gjyqtarët, por roli i tyre duhet të plotësohet nga një grup gjyqtarësh nga e njëjta gjykatë dhe nga gjykata të tjera. Ky grup duhet të marrë parasysh edhe opinionet e personave të jashtëm të cilët punojnë rregullisht me gjyqtarët (si p.sh. avokatët dhe profesorët e të drejtës), në lidhje me përkushtimin, respektimin e palëve dhe të rregullave procedurale nga ana e gjyqtarëve.

31. Vlerësimet duhet të përmbajnë edhe një vlerësim kritik të vendimeve të shkruara të gjyqtarit dhe të mënyrës se si i drejton gjyqet. Vlerësimet duhet të jenë transparente. Gjyqtarët duhet të dëgjohen dhe të informohen mbi rezultatet e vlerësimit dhe të kenë mundësinë e apelimit.

Përgjegjshmëria profesionale nëpërmjet transparencës

32. Si rregull, gjyqet duhet të jenë transparente. Për të dhënë prova të sjelljes së gjyqtarëve në sallën e gjyqit, si dhe për të pasur regjistrime të sakta të gjyqeve, seancat duhet të regjistrohen me mjete elektronike, të cilat bëjnë një riprodhim të plotë. Procesverbalet e shkruara dhe raportet stenografike nuk janë të mjaftueshme. Për të rritur përgjegjshmërinë profesionale dhe publike të gjyqtarëve, vendimet duhet të botohen në baza të dhënash dhe në faqe interneti në mënyrë që ato të jenë vërtet të aksesueshme dhe pa pagesë. Vendimet duhet të indeksohen sipas lëndës, çështjes ligjore që është ngritur dhe emrit të gjyqtarit që i ka shkruar. Duhet të botohen gjithashtu edhe vendimet që dalin nga organet e disiplinës (*shih gjithashtu paragrafin 26*).

33. Për të ndërtuar besimin e publikut në gjykatë, autoritetet duhet të nxisin aksesin e gazetarëve në gjykata dhe të krijojnë pozicionin e sekretarit të shtypit apo specialistit të medias. Nuk duhet të ketë pengesa që gazetarët të ndjekin gjyqet.

Gjykimi i pavarur penal

34. Prirja akuzatore e sistemeve të drejtësisë në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Lindore, Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore kërkon disa përmirësime. Dhënia e pafajësisë ende konsiderohet si një njollë e zezë apo një dështim. Për të pakësuar presionin mbi gjyqtarët për të mënjeluar dhënien e pafajësive, rekomandohet me forcë që të bëhen ndryshime në sistemin e vlerësimeve të tyre profesionale (dhe, nëse është me vend, të konsiderohen edhe ndryshime në vlerësimin e prokurorëve dhe hetuesve). Numri i vendimeve për pafajësi nuk duhet të jetë kurrë një tregues për vlerësimin e gjyqtarëve. Gjyqtarët duhet të tregohen shumë të matur në shqyrtimin e kërkesave për miratimin e masave shtrënguese të arrestit në burg. Rishikimi në apel i vendimeve për pafajësi duhet të bëhet vetëm në rrethana shumë të veçanta.

Pavarësia e brendshme

35. Dhënia e udhëzimeve, shpjegimeve apo zgjidhjeve nga gjykatat e larta, është një dukuri që nuk duhet inkurajuar, por për sa kohë që ekzistojnë, ato nuk duhet të jenë të detyrueshme për gjyqtarët e gjykatave më të ulta, përndryshe përbëjnë shkelje të pavarësisë individuale të gjyqtarëve. Për më tepër, vendimet e gjykatave më të larta dhe vendimet specifike të hartuara si precedentë nga këto gjykata duhet të kenë statusin e rekomandimeve dhe nuk duhet të jenë të detyrueshme për gjyqtarët e gjykatave më të ulta për çështje të tjera. Ato nuk duhet të përdoren për të kufizuar lirinë e gjykatave më të ulta në vendimmarrjen dhe përgjegjësinë e tyre. Interpretimi i unifikuar i ligjit duhet të inkurajohet nëpërmjet studimit të praktikës gjyqësore, e cila gjithashtu nuk ka forcë detyruese.